

VENDIM
Nr. 8, datë 27.1.2016

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “PHOENIX PETROLEUM” SHA, NË
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa “c”; nenit 75, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe neneve 4, pika 1, germa “c”; 8; 9; pika 1 dhe pika 2, germa “f” dhe nenin 10; 11; 12, të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.1.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Phoenix Petroleum” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a.,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Phoenix Petroleum” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullat dhe procedurat për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 1, germa “d”/“i”; “d”/“ii”; “d”/“v”; “d”/“v”; “d”/“vi”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale (neni 9, pika 1, germa “e”/“i”; “e”/“ii”; “e”/“iii”; “e”/“v”; “e”/“vi”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumente specifike për llojin e licencës (neni 9, pika 2, germa “f”/“i”; germa “f”/“ii”; “f”/“iii”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Phoenix Petroleum” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, për një periudhë 10-vjeçare (dhjetëvjeçare).

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti